
**ANALIZA E BUXHETIT TË BASHKISË NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË TË VITIT 2015**

Buxheti i Bashkisë është miratuar me VKB nr. 16 datë 13.03.2015 “Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve të Vartësisë për vitin 2015”, me VKB nr. 76 datë 13.8.2015 “Mbi miratimin e projekt buxhetit të Bashkisë së re për vitin 2015”, si dhe me VKB nr. 113 datë 17.12.2015 “Për miratimin e përdorimit të fondit tranzitor për zbatimin e reformës administrativo-territoriale në vlerën 39,917 mijë lekë. Zbatimi i këtij buxheti gjatë vitit është bazuar në ligje, VKM, udhëzime, VKB si dhe akte ligjore dhe nënligjore dhe konkretisht:

- Ligjin nr 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015".
- Udhëzimin nr. 2 datë 6.02.2012 i Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".
- Udhëzimi plotësues nr. 2 datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”.
- Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligjin 8652, dt 31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar.
- Ligjin nr 9632 datë. 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.
- Ligji 181/2013 datë 28.12.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.
- Udhëzimi i MF nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”.
- VKM nr. 573 datë 3.07.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit publikë”, i ndryshuar.
- Ligjit 8756 dt. 26.03.2002 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar.
- Ligji 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.
- V.K.M nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.
- Ligji nr 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektoriatin e Ndërtimit”, i ndryshuar.
- VKM nr 502 datë 16.04.2008 “Për administrimin e personelit të konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar.
- VKM nr. 1619 dt. 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, i ndryshuar.
- Ligji 7703 dt 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- VKM nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.
- VKM nr. 1198 datë 03.12.2009 “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”.

- VKM nr. 997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.
- VKM 870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.
- VKM nr. 258 datë 03.06.1999 “Për një ndryshim në VKM nr 243 datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”.
- VKM nr. 228 datë 23.04.2004 “Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore”.
- VKM nr. 511 datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore “, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “ Për Menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”.
- VKM nr. 1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Korçë, të Qarkut Korçë”.
- Ligjin nr. 8224 datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunave”, i ndryshuar.
- Ligji 107/2014 datë 23.04.2009 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
- Ligji 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.
- VKM nr.1180 datë 05.08.2008 “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizimin dhe mbledhjen e administrimit e të ardhurave të procesit të legalizimit”.
- Udhëzimin nr. 37 datë 20.11.2008 “Për përdorimin e të ardhurave nga procesi i legalizimit”
- Ligji nr. 9869 datë 4.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 35 datë 05.11.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”.
- VKM nr. 510 datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njesitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.
- Udhëzimi i përbashkët i ministrit për Çështjet Vendore dhe ministrit të Financave nr. 3237, datë 16.7.2015 “Për procedurat, afatet kohore, standartet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial”.
- VKM nr. 664 datë 29.7.2015 “Për shpërndarjen e fondit tranzitor për zbatimin e reformës së re administrativo-territoriale”.
- VKM nr. 557 datë 18.6.2015 “Për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme , pronë private, që preken nga zgjerimi i rrugës “Don Gjon Buzuku”, rijetësimi i sheshit të Xhamisë “Iljaz Bej Mirahori”, rindërtimi i kullës historike të sahatit, rijetësimi i sheshit të hyrjes dhe rikonstruksioni i disa rrugicave të pazarit historik”.

- VKM nr. 831 datë 7.10.2015 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 82 datë 28.1.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës “Don Gjon Buzuku”, Korçë”.
- VKB të miratuara gjatë vitit, urdhëra të Kryetarit të Bashkisë dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore të vitit 2015.

Burimet kryesore të financimit të Buxhetit për vitin 2015 kanë qenë:

- Të ardhurat e trashëguara të vitit 2014.
- Të ardhurat e trashëguara nga Njësitë Administrative të vitit 2015.
- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.
- Të ardhurat e institucioneve të varësisë.
- Transferta e pakushtëzuar.
- Fondi tranzitor.
- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.
- Huamarrja vendore (kredia).
- Sponsorizime të ndryshme.

Për vitin 2015 të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore u planifikuan në vlerën 445,684 mijë lekë dhe si rezultat i ndryshimeve që pësoi buxheti gjatë vitit 2015 ky plan shkoi në vlerën 457,686 mijë lekë. Realizimi gjatë vitit 2015 ka qenë në vlerën 397,595 mijë lekë ose në masën 86.8%.

Të ardhurat nga institucionet e varësisë janë planifikuar në vlerën 16,189 mijë lekë dhe gjatë vitit 2015 ky plan pësoi ndryshime dhe shkoi në vlerën 23,082 mijë lekë. Realizimi ka qenë në vlerën 15,850 mijë lekë ose në masën 68.7%. Gjithashtu gjatë vitit 2015 ka patur dhe një sponsorizim 235 mijë lekë për Qendrën e Artit dhe Kulturës.

Duke iu referuar VKM nr. 510 datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit , aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Bashkisë Korçë iu bashkuan dhe 7 Njësi Administrative, të cilat u shoqëruan edhe me kalimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2015 në vlerën 34,026 mijë lekë. Gjithashtu nga këto njësi u planifikuan të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore për periudhën korrik-dhjetor në vlerën prej 35,970 mijë lekë dhe realizimi ka qenë në vlerën 24,211 mijë lekë ose 67.3%.

Në materialin e analizës së buxhetit do të paraqesim më të detajuar analizën e të ardhurave të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë.

Burimet e financimit jepen si më poshtë:

Burimet e financimit	Vlera në 000/lekë	% për çdo zë ndaj totalit
-Të ardhurat e trashëguara	259,429	15.1%
-Transferta e pakushtëzuar	248,008	14.2%
- Fondi tranzitor	39,917	2%

-Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	373,384	22%
-Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore NJ.A	24,211	1.4%
-Të ardhurat e institucioneve të varësisë	15,850	1%
-Sponsorizime të ndryshme	235	
-Huamarrja vendore(kredia)	50,000	3 %
-Fondi i Zhvillimit të Rajoneve	710,256	41.3%
-5% pullat gjendja civile (shpërblim)	160	
Total	1,721,450	100%

Shpenzimet e realizuara për vitin 2015 jepen si më poshtë:


Shpenzimet	Vlera /000lekë	% për çdo zë ndaj totalit
-Shpenzime personeli(paga+sigurime shoqërore)	208,498	15.2%
-Shpenzimet operative dhe shërbime publike	359,013	26.2%
-Shpenzime (principali & interesi)	27,905	2%
-Subvencione	6,982	0.5%
-Transferta tek organizata të ndryshme	25,646	1.8%
-Transferta tek individët	2,268	0.1%
-Shpenzime kapitale	738,485	54.2%
Total	1,368,797	100%

Transferta e pakushtëzuar

Për vitin 2015 transferta e pakushtëzuar ka qenë në vlerën 248,008 mijë lekë. Gjatë vitit 2015 iu shtua edhe fondi tranzitor në vlerën 39,917 mijë lekë dhe transferta e pakushtëzuar shkoi në vlerën 287,925 mijë lekë. Ecuria e transfertës së pakushtëzuar jepet si më poshtë:

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Transferta e pakushtëzuar	186,488	171,127	167,287	150,337	198,249	230,960	287,925
Total	186,488	171,127	167,287	150,337	198,249	230,960	287,925

Paraqitja grafike



Në zbatim të ligjit nr 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015" si dhe Udhëzimit plotësues nr. 2 datë 09.01.2015 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015", në shpenzimet e personelit administrativ është përdorur 10% e kësaj transferte.

Fondi tranzitor

Në zbatim të VKM nr. 664 datë 29.7.2015 "Për shpërndarjen e fondit tranzitor për zbatimin e reformës së re administrativo-territoriale" për Bashkinë u akordua një fond prej 39,917 mijë lekësh dhe përdorimi i këtij fondi u miratua me VKB nr. 113 datë 17.12.2015 "Për miratimin e përdorimit të fondit tranzitor për zbatimin e reformës administrativo-territoriale në vlerën 39,917 mijë lekë". Ky fond u trashëguua për vitin 2016 dhe përdorimi i tij do të trajtohet në materialin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2016.

REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË, NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2015

Në tabelën e mëposhtme jepet realizimi i të ardhurave të Bashkisë, Njësive administrative dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2015.

Emertimi	Bashkia	NSHP	KI Shmsport	Q Artit dhe Kulture	NSHMAC	Sht e foshnjës	NJMBS	Qendra ditore	Qendra rezid	Total
Të ardhurat	479,200,167.06	4,056,073.00	150,000.00	1,465,150.00	11,115,695.52	147,505.00	10,327,655.28	88,600.00	17,000.00	506,567,845.86
D në buxhet	-1,378,551.43		-45,000.00			-92,025.50		-8,860.00		-1,524,436.93
5% garanci punimesh	-35,968,465.00	-290,623.00			-518,467.00					-36,777,555.00
5% ngurtësim	-175,952.00									-175,952.00
Sponsorizim				-235,000.00						-235,000.00
Pullat 5% derdhur në buxhet	-449,471.00									-449,471.00
Pullat 95% per DRT	-3,960,835.00									-3,960,835.00
Kredia	-50,000,000.00									-50,000,000.00
Vl e mb e te Ardhurave	387,266,892.63	3,765,450.00	105,000.00	1,230,150.00	10,597,228.52	55,479.50	10,327,655.28	79,740.00	17,000.00	413,444,595.93
Celja Jan-Dhj	369,816,535.10	3,080,802.00	105,000.00	1,215,150.00	9,913,768.12	55,479.50		44,370.00	8,500.00	384,239,604.72
Të ardh të pashpërndara	17,450,357.53	684,648.00	0.00	15,000.00	683,460.40	0.00	10,327,655.28	35,370.00	8,500.00	29,204,991.21

Pra siç shihet dhe nga tabela në total të ardhurat janë realizuar në vlerën 413,445 mijë lekë , nga të cilat për realizimin e shpenzimeve të vitit 2015 janë çelur 384,240 mijë lekë dhe vlera prej 29,205 mijë lekë janë të ardhura të papërdorura nga viti 2015 dhe do të përdoren gjatë vitit 2016.

Totali i të ardhurave të trashëguara të vitit 2015 sipas burimeve të financimit dhe sipas institucioneve është në vlerën 352,652,992.61 lekë. Këto të ardhura do të jenë pjesë e buxhetit të vitit 2016 dhe përdorimi i tyre do të paraqitet në materialin e buxhetit 2016 Këto të ardhura jepen në tabelën e mëposhtme:

Institucionet	Të ardh nga Transferta e pakushtëzuar	Të ardhura nga fondi tranzitor	Të ardhura nga Banesat sociale	Të ardhura nga FZHR	Të ardhura nga sponsorizimi	Të ardhura nga kredia	Të ardhura nga Shp dhe të ardhurat	Të ardh të trash viti 2015
Arsimi 9 vjeçar	1,403,492.00						1,362,015.62	2,765,507.62
Arsimi i mesëm							131,850.00	131,850.00
Arsimi prof	291,152.00						3,732.40	294,884.40
Klubi shumësportesh	320,479.00						120,972.00	441,451.00
Klubi I futbollit	171,665.00						536,391.00	708,056.00
Qendra e Artit dhe kulturës	1,594,145.00				35,000.00		953,241.00	2,582,386.00
NJMBQS			550,371.00					550,371.00
NSHP		30,671,481.00					3,246,274.21	33,917,755.21
Bashkia	158,885.00	6,696,482.00	12,696,847.28	240,639,730.00	1,068.00	18,152,148.00	26,761,043.14	305,106,203.42
Shërbimi urban	17,680.00							17,680.00
Shërbimi I pastrimit							5,926,086.96	5,926,086.96
Mirëmb varrez publ dhe dësh							34,680.00	34,680.00
Qendra rezidenciale							10,375.00	10,375.00
Qendra ditore							53,118.00	53,118.00
Shtëpia e foshnjes					77,981.00		34,607.00	112,588.00
Totali	3,957,498.00	37,367,963.00	13,247,218.28	240,639,730.00	114,049.00	18,152,148.00	39,174,386.33	352,652,992.61

PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2015

TAKSA MBI NDËRTESEN


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
1	Taksa mbi ndërtesën	74 000 000	77 350 802	105 %

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 74 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 105% ose në vlerë 77 350 802 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga 284 subjekte për vitin 2015 në vlerën 25 941 424 lekë si dhe nga 63 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 5 074 353 lekë nga subjektet e biznesit të madh, nga 1,680 subjekte për vitin 2015 në vlerën 22,382,787 lekë si dhe nga 135 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 1 758 048 lekë nga subjektet e biznesit të vogël, nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO për vitin 2015 në vlerën 20 042 365 lekë, nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO për vitet paraardhëse në vlerën 2 618 871 lekë si dhe nga familjarët pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh dhe kanë likujduar detyrimet në mënyrë vullnetare në vlerën 147 954 lekë.

Po nga kjo taksë shuma prej 615 000 lekësh është kaluar për llogari të KLSH. Realizimi në këtë masë vjen si rezultat i punës së kryer nga ana e inspektorëve në terren, pagimit brenda afateve ligjore nga familjarët, nga ana e subjekteve të biznesit të madh dhe biznesit të vogël, nga bashkëpunimi ndërmjet të gjitha Drejtorive të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë apo institucioneve të tjera si dhe nga zbatimi i masave shtënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitore.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi ndërtesën për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Taksa mbi ndërtesën	38 420 552	43 777 278	45 728 925	67 425 174	77 350 802



Më poshtë nëpërmjet tabelës po japim trendin e realizimit të taksës mbi ndërtesën për Njësitë Administrative për 6-mujorin e dytë 2015 :

Njësitë Administrative	Planifikimi 2015 6 - mujori	Realizimi 2015 6 - mujori	Përqindja
Njësia Administrative Mollaj	300 000	442 323	147%
Njësia Administrative Vithkuq	79 000	97 500	123%
Njësia Administrative Bulgarec	200 000	1 985 705	993%
Njësia Administrative Drenovë	1 250 000	1 425 961	114%
Njësia Administrative Voskopojë	200 000	160 606	80%
Njësia Administrative Voskop	1 158 561	123 450	11%
Njësia Administrative Lekas			


TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
2	Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	4 000 000	9 231 294	231 %

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme e cila planifikohet dhe mbledhet nga agjenti tatimor i cili është ZVRPP Korçë, për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 4 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 231 % ose e shprehur në vlerë 9 231 294 lekë. Duke filluar nga viti 2014 e në vazhdim, duke patur për qëllim rritjen e transparencës midis dy institucioneve, fuqizuar nivelin e bashkëpunimit si dhe monitorimin e performancës së ZVRPP Korçë në lidhje me zërin tatim shitjeje pasuri e paluajtshme përveç akt rakordimit mujor kemi në dispozicion evidenca të detajuara me numrin, sipërfaqen dhe vlerën e objekteve të cilat kanë ndëruar pronësinë për çdo muaj.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015 :

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	5 129 970	3 828 227	6 461 126	5 663 311	9 231 294



TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
3	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	100 000 000	55 948 533	56 %

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël në buxhetin e vitit 2015 është planifikuar 100 000 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2015 është në masën 56 % ose në vlerë 55 948 533 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i arkëtimit në vlerën 958 359 lekë si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitore nga ana e Bashkisë Korçë nga subjektet e biznesit të vogël detyrime këto nga vitet paraardhëse si taksë vendore dhe nga arkëtimi i vlerës 54 990 174 lekë të cilat janë derdhur për llogari të Bashkisë Korçë nga DRT Korçë nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël ku kjo e fundit bazuar në legjislacionin aktual në fuqi është në rolin e agjentit tatimor.

Ky nivel kaq i ulët i realizimit të të ardhurave edhe për vitin 2015 vjen si pasojë e ndryshimit të Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 32 datë 31.12.2013 i ndryshuar, ku subjektet me xhiro vjetore të deklaruar nga 0 deri në 2 milion lekë paguajnë tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël në vlerën 25 000 lekë dhe për pjesën e subjekteve të cilët realizojnë një qarkullim vjetor nga 2 deri në 8 milionë lekë parapaguajnë tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të ndarë në katër kështe vjetore. Shuma vjetore e parapagimeve llogaritet duke marrë parasysh qarkullimin gjithsej dhe fitimin e tatueshëm të një viti më parë të deklaruar nga tatimpaguesi, bazuar në deklaratën vjetore të të ardhurave personale të biznesit të vogël, të bërë në zbatim të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar dhe pjesa më e madhe e këtyre subjekteve kanë deklaruar qarkullim vjetor deri në 2 milion lekë dhe sipas legjislacionit në fuqi paguajnë 25 000 lekë. Kjo gjë është kundërshtuar që në fillim dhe vazhdon të kundërshtohet nga ana jonë duke i paraprirë situatës që do të ndodhte në vazhdim në realizimin e këtij zëri dhe i është kërkuar DRT Korçë në mënyrë të përsëritur informacion në lidhje me deklaratimet e subjekteve si dhe informacion në lidhje me monitorimin e xhiros së subjekteve me qëllim deklarimin real të të ardhurave dhe pagimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin sipas qarkullimit real pasi nga të dhënat që ne disponojmë duke i krahasuar dhe me nivelin e qarkullimit vjetor të parashikuar dhe parapagimit të bërë nga ana e tyre pranë Bashkisë Korçë gjatë gjithë periudhës kur këto subjekte paguanin pranë nesh taksën vendore të biznesit të vogël deklarimet e tyre nuk ishin reale. Falë këmbënguljes së vazhdueshme nga ana jonë por dhe punës të kryer nga ana e DRT Korçë kemi një përmirësim të ndjeshëm të situatës në lidhje me pagimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël krahasuar kjo me një vit më parë por që nga ana e kësaj të fundit e cila njëkohësisht është dhe në rolin e agjentit tatimor mbetet të kërkohej më shumë në lidhje me monitorimin e xhiros së subjekteve me qëllim deklarimin real të të ardhurave dhe pagimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin sipas qarkullimit real.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës vendore të biznesit të vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitet 2011 – 2012– 2013 dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për 2014 - 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	93 874 914	89 192 648	82 769 863	41 487 797	55 948 533




TAKSA E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
4	Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	17 000 000	20 649 408	121 %

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor e cila planifikohet dhe mbledhet nga agjenti tatimor i cili është D.R.SH.T.RR Korçë, për vitin 2015 është planifikuar 17 000 000 lekë dhe realizimi i saj për vitin 2015 është në masën 121 % ose në vlerë 20 649 408 lekë. Duke filluar nga viti 2014 e në vazhdim duke patur për qëllim rritjen e transparencës midis dy institucioneve, fuqizuar nivelin e bashkëpunimit si dhe monitorimin e performancës së D.R.SH.T.RR Korçë në lidhje me këtë zë përveç akt rakordimit mujor kemi kërkuar dhe na janë vënë në dispozicion evidenca të detajuara me numrin dhe pronësinë e mjeteve si dhe vlerën e paguar për çdo mjet, për çdo muaj.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor për vitet 2011 – 2012 -2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	15 501 348	23 380 418	21 497 777	16 648 777	20 649 408




TARIFË REGJISTRIM BIZNESI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
5	Tarifë regjistrim biznesi	3 500 000	5 392 500	154 %

Tarifë regjistrim biznesi për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 3 500 000 lekë dhe është realizuar në masën 154 % ose në vlerën 5 392 500 lekë, kjo si rezultat i regjistrimit dhe pagimit nga ana e 449 subjekteve të reja gjatë vitit 2015, në vlerën 4 500 000 lekë dhe nga pagimi i 78 subjekteve të regjistruara nga vitet e mëparshme por që pagesat i kanë kryer gjatë vitit 2015 në vlerën 892 500 lekë. Realizimi në këtë masë është si rezultat i punës të kryer nga ana e inspektoreve në terren.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së regjistrimit të biznesit për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015 :

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë regjistrim biznesi	3 020 000	2 746 500	2 770 000	3 165 000	5 392 500




TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	46 006 573	7 836 125	17 %

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 46 006 573 lekë, dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 17 % ose në vlerën 7 836 125 lekë. Parashikimi për këtë taksë është bërë duke menduar se zhblokimi i lejeve të ndërtimit do të kryhej që në fillim të vitit 2015, ndërkohë që dhënia e lejeve të ndërtimit filloi prej muajit Mars të vitit 2015 me kufizimet (lejoreshin të ndërtoreshin vetëm banesa individuale me sipërfaqe ndërtimi deri në 250 m²) në muajin Shtator kanë filluar dhe janë dhënë leje ndërtimi sipas Planit të Përgjithshëm Vendor. Një tjetër faktor që solli vështirësi dhe frenoi ndjeshëm numrin e aplikimeve për leje ndërtimi ishte ndryshimi i procedurave për aplikim për leje ndërtimi. Duhet të theksojmë këtu se taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja ashtu sikundër dhe për vitet më përpara ka zënë një peshë mjaft të rëndësishme në të ardhurat e Bashkisë Korçë gjë, e cila ndikoi dhe gjatë vitit 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	67 162 277	4 929 863	118 347	1 695 305	7 836 125



Më poshtë nëpërmjet tabelës po japim trendin e realizimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për njësitë e tjera administrative për 6-mujorin e dytë 2015:

Njësitë Administrative	Planifikimi 2015 6 - mujori	Realizimi 2015 6 - mujori	Përqindja
Njësia Administrative Bulgarec	200 000	142 332	71%
Njësia Administrative Drenovë	90 908	53 388	59%
Njësia Administrative Voskopojë	4 000	1 310	33%

TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	3 000 000	4 253 803	142 %

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 3 000 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 142 % ose në vlerën 4 253 803 lekë. Planifikimi për këtë taksë është bërë duke marrë për bazë ritmet e ulëta të kryerjes së legalizimeve për qytetin e Korçës referuar viteve paraardhëse deri në vitin 2014 nga ALUIZNI (theksojmë këtu që vitet 2013 - 2014 i kemi marrë si vite referuese për arkëtimet e kësaj takse) por gjatë vitit 2015 i cili u shoqërua me një trend në

ritje të dhënieve të lejeve të legalizimit për aplikantët që kishin dorëzuar dokumentacionin që prej fillimit të këtij procesi solli që nga ana jonë të arketoheshe një vlerë relativisht të barabartë me vitet 2011-2012 ku numri i lejeve të legalizimit për qytetin e Korçës ishte në nivele të relativisht të larta.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	4 671 413	4 563 743	2 735 018	449 262	4 253 803




TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
8	Tarifë regjistrimi për lejë transporti	1 000 000	955 207	96%

Tarifë regjistrimi leje transporti për vitin 2015 është planifikuar 1 000 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 96 % ose në vlerë 955 207 lekë, nga të cilat 134 927 lekë nga transporti i mallrave për llogari të vet, 41 330 lekë nga transporti i mallrave për të tretë, 58 650 lekë nga transporti i udhëtarëve me autobuzë (ndër qytetës dhe rreth qytetës), 618 300 lekë nga transporti i udhëtarëve me taksi dhe 102 000 lekë nga autorizimet për automjete të tonazhit të lartë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së regjistrim për lejë transporti për vitet 2011 – 2012 - 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë regjistrimi për lejë transporti	2 841 470	853 305	220 940	493 880	955 207




TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
9	Taksa e fjetjes në hotel	2 000 000	3 327 481	166%

Taksë fjetje në hotel për vitin 2015 është parashikuar 2 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 166% ose në vlerën 3 327 481 lekë, këto nga subjektet që japin strehim kundrejt pagesës siç janë hotelet, motelet, bujtinat dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin administrativ të Bashkisë Korçë. Siç duket dhe nga realizimi i kësaj takse ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit vizitorëve dhe turistëve në qytet e cila përveç rritjes së numrit të subjekteve që operojnë dhe ofrojnë shërbimin në këtë fushë ka sjellë dhe pothuaj dyfishimin e taksës së fjetjes në hotel për vitin 2015. Ky faktor tregon më së miri që qyteti ynë falë lehtësive fiskale për të gjithë operatorët që ushtrojnë këtë lloj aktiviteti nga viti në vit po bën atraksion turistik jo më vetëm gjatë stinës së verës por gjatë gjithë vitit.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksë fjetje në hotel për vitet 2011 – 2012– 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Taksa e fjetjes në hotel	1 730 389	1 886 089	1 786 448	1 666 638	3 327 481




TAKSË THERJE BAGËTIE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
10	Taksë therje bagëtie	800 000	784 900	98%

Taksë therre bagëtie për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 800 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2015 është në masën 98 % ose në vlerën 784 900 lekë. Ky realizim ka ardhur si rezultat i therjes së 7664 krerë bagëti gjatë vitit 2015 nga të cilat 2619 gjedhë në vlerën 523 800 lekë, 4206 bagëti të imta në vlerën 210 300 lekë, 839 derra në vlerën 41 950 lekë si dhe nga arkëtimi i vlerës 8850 lekë detyrim nga viti i mëparëshëm.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksë therre bagëtie për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015 :

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Taksë therre bagëtie	619 850	761 150	744 600	754 600	784 900


**TAKSA E REKLAMËS**

Nr	Lloji i Taksës ose Tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
11	Taksa e Reklamës	14 000 000	12 794 035	91 %

Taksa e reklamës për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 14 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 91 % ose në vlerë 12 794 035 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga 133 subjekte për vitin 2015 në vlerën 9 619 075 lekë si dhe nga 26 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 2 024 238 lekë nga subjektet e biznesit të madh, nga 59 subjekte për vitin 2015 në vlerën 951 972 lekë si dhe nga 9 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 198 750 lekë nga subjektet e biznesit të vogël. Në mosrealizim e kësaj takse ndikim kryesor pati heqja e reklamave të tipit billboard gjatë vitit 2015 të firmave reklamuese të cilat ushtronin aktivitetin e tyre reklamues në teritorin e Bashkisë Korçë por dhe mospagimi brenda vitit 2015 nga një pjesë subjektsh për të cilat do fillojnë masat shtërnguese ligjore për mbledhjen e detyrimeve.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së reklamës për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Taksa e Reklamës	13 365 875	13 103 438	13 744 478	18 551 722	12 794 035


**TAKSA E TABELËS**

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
12	Taksa e Tabelës	251 000	290 326	116 %

Taksa e tabelës për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 251 000 lekë dhe është realizuar në masën 116% ose në vlerën 290 326 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga 398 subjekte për vitin 2015 në vlerën 49 290 lekë si dhe nga 98 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 15 746 lekë nga subjektet e biznesit të madh, nga 2031 subjekte për vitin 2015 në vlerën 198 207 lekë si dhe nga 175 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 22 403 lekë nga subjektet e biznesit të vogël, , nga 31 institucionet shtetërore për vitin 2015 në vlerën 3 720 lekë, nga 4 institucione shtetërore debitorë për vitet e mëparëshme në vlerën 960 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së tabelës për vitet 2011 – 2012 -2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Taksa e tabelës	254 770	261 280	247 250	250 970	290 326


**TARIFË MUR PERIMETRAL**

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
13	Tarifë mur perimetral	809 000	149 326	18 %

Tarifë mur perimetral për vitin 2015 është planifikuar 809 000 lekë dhe është realizuar në masën 18% ose në vlerë 149 326 lekë. Parashikimi për këtë tarifë është bërë duke menduar se zhbllokimi I lejeve të ndërtimit do të kryhej që në fillim të vitit 2015, ndërkohë që dhënia e lejeve të ndërtimit filloi prej muajit Mars të vitit 2015 me kufizimet (lejoheshin të ndërtoheshin vetëm banesa individuale me sipërfaqe ndërtimi deri në 250 m²) në muajin Shtator kanë filluar dhe janë dhënë leje ndërtimi sipas Planit të Përgjithshëm Vendor. Një tjetër faktor që solli vështirësi dhe frenoi ndjeshëm numrin e aplikimeve për leje ndërtimi ishte ndryshimi i procedurave për aplikim për leje ndërtimi.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës mur perimetral për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë mur perimetral	845 680	87 410	0	23 000	149 326




TARIFË PËR SHËRBIM ME TAVOLINA JASHTË LOKALIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
14	Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	2 800 000	3 444 200	123 %

Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit për vitin 2015 është parashikuar në vlerën 2 800 000 lekë dhe është realizuar në masën 123 % ose në vlerën 3 444 200 lekë. Kjo tarifë është realizuar në masën 123% si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmarra nga ana e Bashkisë Korçë, në evidentimin e saktë nga ana e inspektorëve të numrit të tavolinave të biznesit të vogël dhe të madh që vendosen jashtë ambjenteve të lokaleve si dhe në ndjekjen e arkëtimit të kësaj tarife brenda afateve të përcaktuara. Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për shërbim me tavolina jashtë lokalit për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015 :

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	1 968 500	2 741 275	2 022 300	2 595 300	3 444 200




TARIFA E PASTRIMIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
15	Tarifa e Pastrimit	80 000 000	70 971 763	89 %

Tarifa e pastrimit për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 80 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 89% ose në vlerë 70 971 763 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga 395 subjekte për vitin 2015 në vlerën 17 746 253 lekë si dhe nga 97 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 5 574 499 lekë nga subjektet e biznesit të madh, nga 2065 subjekte për vitin 2015 në vlerën 9 535 721 lekë si dhe nga 178 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 981 919 lekë nga subjektet e biznesit të vogël, nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO për vitin 2015 në vlerën 31 993 974 lekë, nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO për vitet paraardhëse në vlerën 3 299 304 lekë, nga familjarët pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh dhe kanë likuiduar detyrimet në mënyrë vullnetare në vlerën 656 493 lekë, nga 31 institucionet shtetërore në vlerën 94 600 lekë, nga 4 institucione shtetërore debitorë për vitet e mëparëshme në vlerën 59 000, nga 18 subjekte ndërtuese për kantierin e ndërtimit në vlerën 1 030 000 lekë. Në këtë zë ndikim të ndjeshëm në mosrealizim ka pasur tarifa e pastrimit për familjarët referuar këtu planifikimit të bërë pasi në planifikim sidomos në të ardhurat e parashikuara për këtë targetgrup bazë është marrë nr i familjeve sipas gjendjes civile. Duhet të theksojmë se realizimi në këtë masë vjen si rezultat i punës së kryer nga ana e inspektorëve në terren, pagimit brenda afateve ligjore nga familjarët, nga ana e subjekteve të biznesit të madh dhe biznesit të vogël, nga bashkëpunimi ndërmjet të gjitha drejtorive të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë apo institucioneve të tjera si dhe nga zbatimi i masave shtënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitorë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së pastrimit për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifa e Pastrimit	40 344 535	49 719 607	58 843 384	62 825 304	70 971 763



Më poshtë nëpërmjet tabelës po japim trendin e realizimit të tarifës së pastrimit për Njësitë Administrative për 6-mujorin e dytë 2015 :

Njësitë Administrative	Planifikimi 2015 6 - mujori	Realizimi 2015 6 - mujori	Përqindja
Njësia Administrative Mollaj	550 000	880 696	160%
Njësia Administrative Vithkuq	110 000	67 000	61%
Njësia Administrative Bulgarec	550 000	816 866	149%
Njësia Administrative Drenovë	729 162	738 485	114%
Njësia Administrative Voskopoje	40 000	120 034	300%
Njësia Administrative Voskop	224 900	103 950	46%


TARIFË SHËRBIMI , VËRTETIME ,ÇERTIFIKATA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
16	Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata	6 000 000	8 735 642	146 %

Të ardhura të tjera (tarifa shërbimi, vërtetime, çertifikata, etj), për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 6 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 146 % ose në vlerën 8 735 642 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifave të shërbimit, vërtetime, çertifikata, etj për vitet 2011 – 2012- 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata	3 237 085	5 991 427	5 925 621	10 526 585	8 735 642




TARIFË PARKIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
17	Tarifë Parkimi	11 700 000	13 464 927	115%

Tarifë parkimi për vitin 2015 është planifikuar 11 700 000 lekë dhe deri në fund të vitit 2015 është realizuar në masën 115 % ose në vlerë 13 464 927 lekë. Realizimi i kësaj tarife vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga ana jonë në vlerën 2 144 927 lekë ku përfshihen tarifa e parkimit të rezervuar për institucionet apo subjektet, tarifa e parkimit për shërbimin e transportit të udhëtarëve me taksì, tarifa e parkimit të subjekteve transportit të udhëtarëve që operojnë me linja ndërqytetëse si dhe në vlerën 11 320 000 lekë tarifë parkimi e arkëtuar nga subjekti i kontraktuar për vjeljen e tarifës së parkimit në qytet në vendparkimet e miratuara me pagesë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të Tarifës së Parkimit për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë Parkimi	2 779 935	2 422 740	1 943 306	5 480 070	13 464 927


**GJOBA POLICIA BASHKIAKE**

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
18	Gjoba Policia Bashkiake	300 000	208 000	69 %

Gjoba Policia Bashkiake për vitin 2015 është planifikuar 300 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2015 është në masën 69% ose në vlerën 208 000 lekë. Gjatë vitit 2015 në total janë vendosur 253 gjoba nga të cilat 225 janë arkëtuar brenda vitit 2015 në vlerën 208 000 lekë dhe 28 gjoba për vlerën 36 500 lekë janë të pa arkëtuara dhe po ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e tyre.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit gjopa Policia Bashkiake për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015 :

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Gjopa Policia Bashkiake	64 500	42 000	19 000	22 000	208 000




KAMAT VONESA + GJOBA TË BIZNESIT TË VOGËL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
19	Kamat vonesa	200 000	2 196 147.60	1098 %

Gjopa të biznesit të vogël për vitin 2015 është planifikuar 200 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2015 është në masën 1098 % ose në vlerën 2 196 147.60 lekë. Ky zë është realizuar në vlerën 384 546 nga subjektet debitore të biznesit të vogël të krijuar deri në vitin 2013 kur këto subjekte paguanin pranë Bashkisë Korçë taksën vendore të biznesit të vogël dhe të arkëtuara gjatë vitit 2015 nga zbatimi i masave shtënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitore si dhe në vlerën 1 811 601.6 lekë nga subjektet e biznesit të vogël, subjektet e biznesit të madh, pronarët e ndërtesave apo ata të tokave bujqesore të cilët kanë likujduar taksat dhe tarifat lokale jashtë afateve të miratuara në Vendimin e Këshillit të Bashkisë për vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të kamat vonesave për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Kamat vonesa	675 761	619 873	757 239	447 455	2 196 147.60




GJOBA TË INSPEKTORIATIT NDËRTIMOR VENDOR

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
20	Gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor	2 500 000	730 000	29 %

Gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 2.500.000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2015 është në masën 29 % ose në vlerën 730 000 lekë. Në këtë zë ndikim të ndjeshëm në mosrealizim ka mos arkëtimi brenda vitit 2015 i 9 gjobave të vendosura nga vitet e mëparëshme janë në proces vjeljeje nga ana e përmbarimit në vlerën 1 780 000 lekë, i 2 gjobave të vendosura nga vitet e mëparëshme janë në proces gjyqësor në vlerën 150 000 lekë dhe i 1 gjobe të vendosur në vitet e mëparëshme por që është në proces gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë në vlerën 2 000 000 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjobave të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015 :

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor	150 000	1 120 000	2 030 000	1 390 000	730 000




GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
21	Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit	150 000	149 000	99 %

Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 150 000 lekë, dhe është realizuar në masën 99 % ose në vlerën 149 000 lekë. Gjatë vitit 2015 në total janë vendosur 20 gjoba nga të cilat 13 janë arkëtuar brenda vitit 2015 në vlerën 144 000 lekë, 1 gjobë e vitit të mëparshëm është arkëtuar po gjatë vitit 2015 në vlerën 5 000 lekë dhe 7 gjoba për vlerën 90 000 lekë janë të pa arkëtuara dhe po ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e tyre.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjobave të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit	72 000	125 000	55 000	33 000	149 000




QERA OBJEKTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
22	Qëra Objekti	1 260 248	1 315 445.5	104%

Qëra objekti për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 1 260 248 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2015 është në masën 104 % ose në vlerën 1 315 445.5 lekë. Në realizim e këtij zëri janë përmbledhur qera objekti e cila gjatë vitit 2015 është arkëtuar në vlerën 637 537.5 lekë dhe qera trualli e cila gjatë vitit 2015 është arkëtuar në vlerën 677 908 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit qera objekti për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Qera objekti	672 005	1 550 338	819 935	1 055 032	1 315 445.5


**QERA SIPËRMARRJE**

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
23	Qera sipërmarrje	432 000	36 000	8 %

Qera sipërmarrje për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 432 000 lekë dhe është realizuar në masën 8 % në vlerën 36 000 lekë. Ky zë nuk është realizuar pasi për vitin 2015 nuk ka pasur objekte të dhëna me qera sipërmarrje.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit qera sipërmarrje për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Qera sipërmarrje	0	864 000	396 000	432 000	36 000




TARIFË PLAN VENDOSJE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
24	Tarifë plan vendosje	100 000	90 000	90 %

Tarifë plan vendosje për vitin 2015 është planifikuar 100 000 lekë, dhe është realizuar në masën 90 % ose në vlerën 90 000 lekë. Parashikimi për këtë tarifë është bërë së pari duke ju referuar dhe realizimit të vitit 2014 por dhe duke menduar se zhbllokimi i lejeve të ndërtimit do të kryhej që në fillim të vitit 2015, ndërkohë që dhënia e lejeve të ndërtimit filloi prej muajit Mars të vitit 2015 me kufizimet (lejoreshin të ndërtoheshin vetëm banesa individuale me sipërfaqe ndërtimi deri në 250 m²) në muajin Shtator kanë filluar dhe janë dhënë leje ndërtimi sipas Planit të Përgjithshëm Vendor. Një tjetër faktor që solli vështirësi dhe frenoi ndjeshëm numrin e aplikimeve për leje ndërtimi ishte ndryshimi i procedurave për aplikim për leje ndërtimi.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së plan vendosjes për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015 :

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë plan vendosje	96 000	0	0	192 000	90 000




TARIFË NDRIÇIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
25	Tarifë Ndriçimi	31 000 000	26 457 677	85 %

Tarifa e ndriçimit për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 31 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 85% ose në vlerë 26 457 677 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga 393 subjekte për vitin 2015 në vlerën 3 694 754 lekë si dhe nga 100 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 1 154 444 lekë nga subjektet e biznesit të madh, nga 2065 subjekte për vitin 2015 në vlerën 7 341 797 lekë si dhe nga 178 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 602 472 lekë nga subjektet e biznesit të vogël, nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO për vitin 2015 në vlerën 11 925 868 lekë, nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO për vitet paraardhëse në vlerën 1 220 552 lekë, nga familjarët pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh dhe kanë likujduar detyrimet në mënyrë vullnetare në vlerën 250 290 lekë, nga 31 institucionet shtetërore në vlerën 152 500 lekë, nga 4 institucione shtetërore debitorë për vitet e mëparëshme në vlerën 40 000, nga 18 subjekte ndërtuese për kantierin e ndërtimit në vlerën 75 000 lekë. Në këtë zë ndikim të ndjeshëm në mosrealizim ka pasur tarifa e ndriçimit për familjarët referuar këtu planifikimit të bërë pasi në planifikim sidomos në të ardhurat e parashikuara për këtë targetgrup bazë është marrë nr. i familjeve sipas gjendjes civile. Duhet të theksojmë se realizimi në këtë masë vjen si rezultat i punës së kryer nga ana e inspektorëve në terren, pagimit brenda afateve ligjore nga familjarët, nga ana e subjekteve të biznesit të madh dhe biznesit të vogël, nga bashkëpunimi ndërmjet të gjitha drejtorive të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë apo institucioneve të tjera si dhe nga zbatimi i masave shtënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitorë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së ndriçimit për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë Ndriçimi	11 178 626	15 424 960	17 774 748	23 704 862	26 457 677



Më poshtë nëpërmjet tabelës po japim trendin e realizimit të tarifës së ndriçimit për Njësitë Administrative për 6-mujorin e dytë 2015 :

Njësitë Administrative	Planifikimi 2015 6 - mujori	Realizimi 2015 6 - mujori	Përqindja
Njësia administrative Mollaj	500 000	513 814	103%
Njësia Administrative Vithkuq	65 000	2 400	4%
Njësia Administrative Drenovë	166 665	357 911	215%
Njësia Administrative Voskopojë	100 000	66 000	66%
Njësia Administrative Voskop	513 600	151 200	29%

TARIFË GJELBËRIMI


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
26	Tarifë Gjellbërimi	20 000 000	17 214 889	86 %

Tarifa e gjellbërimit për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 20 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 86% ose në vlerë 17 214 889 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga 393 subjekte për vitin 2015 në vlerën 2 114 905 lekë si dhe nga 97 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 641 742 lekë nga subjektet e biznesit të madh, nga 2065 subjekte për vitin 2015 në vlerën 4 201 475 lekë si dhe nga 179 subjekte për vitet paraardhëse në vlerën 344 647 lekë nga subjektet e biznesit të vogël, nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO për vitin 2015 në vlerën 8 561 150 lekë, nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO për vitet paraardhëse në vlerën 877 272 lekë, nga familjarët pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh dhe kanë likujduar detyrimet në mënyrë vullnetare në vlerën 178 198 lekë, nga 31 institucionet shtetërore në vlerën 152 500 lekë, nga 4 institucione shtetërore debitorë për vitet e mëparëshme në vlerën 40 000, nga 18 subjekte ndërtuese për kantierin e ndërtimit në vlerën 103 000 lekë. Në këtë zë

ndikim të ndjeshëm në mosrealizim ka pasur tarifa e gjelbërimit për familjarët referuar këtu planifikimit të bërë pasi në planifikim sidomos në të ardhurat e parashikuara për këtë targetgrup bazë është marrë nr i familjeve sipas gjëndjes civile. Duhet të theksojmë se realizimi në këtë masë vjen si rezultat i punës së kryer nga ana e inspektorëve në terren, pagimit brenda afateve ligjore nga familjarët, nga ana e subjekteve të biznesit të madh dhe biznesit të vogël, nga bashkëpunimi ndërmjet të gjitha drejtorive të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë apo institucioneve të tjera si dhe nga zbatimi i masave shtënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitore.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së gjelbërimit për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë Gjelbërimi	7 270 496	10 545 989	12 084 451	15 503 114	17 214 889



TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONË PUBLIKE


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
27	Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike	700.000	657.368	94 %

Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike për vitin 2015 është planifikuar 700 000 lekë dhe është realizuar në masën 94 % ose në vlerën 657 368 lekë. Për planifikimin e këtij zëri jemi bazuar në të dhënat e marra nga grupi i punës i cili ka inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet e subjekteve që kanë zënë prona publike për zhvillimin e aktivitetit të tyre dhe realizimi vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë si dhe është ndjekur me përparësi vjelja e këtij

detyrimi nga subjektet dhe pronarët të cilët duhet ta paguajnë këtë tarifë brenda afateve të përcaktuara.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për servitutin e kalimit në pronë publike për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike	301 860	377 060	337 820	679 464	657 368



TARIFE PËRDORIMI I TREGUT TË LIRË TË QYTETIT


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
28	Tarifë përdorimi i tregut të lirë të qytetit	4 300 000	2 622 220	61 %

Tarifë përdorimi tregu i lirë i qytetit për vitin 2015 është planifikuar 4 300 000 lekë dhe është realizuar në masën 61 % ose në vlerën 2 622 220 lekë. Ky realizim në këtë masë vjen si rezultat i largimit nga hapësira publike të tregëtarëve që tregëtonin tek tregu i vjetër i qytetit (Sheshi Iliria dhe rruget lidhëse) i cili gjatë vitit 2015 ju nënshtrua një rikonstruksioni total të tij me një vlerë të munguar respektivisht; tregëtarët e sheshit ku u ngrit kantieri i ndërtimit 22 subjekte me vlerë 396 000 lekë, 40 subjekte që shfrytëzonin hapsirën publike në sheshi Iliria në vlerën 216 000 lekë, 37 subjekte që shfrytëzonin hapsirën publike në rruget lidhëse në vlerën 66 600 lekë, largimi nga zona e tregut i mjeteve të cilat zhvillonin aktivitet me limit të kufizuar kohor pasi duke filluar nga muaji Prill 2015 e në vazhdim ky vend parkimi i lirë u kthye në vendparkim me pagesë si shkak dhe i përfundimit të investimit publik që ju nënshtrua kjo zonë me vlerë të munguar për këtë shkak 72 000 lekë, largimi i tregëtarëve ambulantë që tregëtonin në hapësirat publike (trotare dhe vend pushimet), faktor tjetër që ndikoi ishte se një pjesë e tregëtarëve të rrobave të përdorura nuk ishin prezentë ose dilnin me intervale jo periodike në treg prej muajit Mars e në vazhdim me vlerë të munguar 384 700 lekë, vlen të përmendim dhe

respektimin rigoroz të kufizimit të sipërfaqeve të cilat subjektet i shfrytëzonin për zhvillimin e aktivitetit të tyre duke pasur në fokus kryesor lirimin e hapësirave publike, kthimin e tyre qytetarëve dhe kthimin në identitet të komplet zonës muzeale Pazarit Korçë si një vlerë e rikthyer e qytetit. Gjithashtu fakt për tu përmendur është dhe mospagimi brenda vitit 2015 i tarifës së përdorimit tregut të lirë të qytetit për shkak të zhvendosjes dhe shfrytëzimit nga ana e tregëtarëve i tregut të ri të rikonstruktuar nga ana e Bashkisë Korçë në ambientet e ish U.M.B i cili u bë i mundur në muajin Nëntor të vitit 2015 me përfundim komplet të punimeve për ambientet e tregut dhe ato të Inkubatorit të Biznesit. Vlera mujore e cila duhet të arkëtohet nga të gjithë tregëtarët të cilët zhvillojnë aktivitetin brenda këtij ambienti në qoftë se do ta shfrytëzojnë për gjatë të gjithë muajit përlogaritët në vlerën 380 700 lekë. Për të gjithë tregëtarët të cilët nuk mundën ta paguanin këtë tarifë brenda vitit 2015 kanë filluar të meren masat shtërnguese për mbledhjen e këtij detyrimi.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së përdorimit të tregut të lirë të qytetit për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë përdorimi i tregut të lirë të qytetit	10 721 136	5 316 780	501 160	4 262 690	2 622 220



TARIFË LEJË PËRDORIMI KANTINA


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
29	Tarifë lejë përdorimi kantina	874 000	787 970	90 %

Tarifë lejë veprimtarie kantina për vitin 2015 është planifikuar 874 000 lekë dhe është realizuar në masën 90 % ose në vlerën 787 970 lekë. Ky mosrealizim vjen si shkak i largimit nga hapësira publike i një subjekti i cili për shkak të përfundimit të investimit publik në atë zonë ka ndërprerë lejën e aktivitetit prej muajit Korrik në vlerën 43 000 lekë detyrim ky që do paguhej për periudhën Korrik - Dhjetor 2015 dhe aplikimit për ç’regjistrim aktiviteti të një subjekti tjetër i cili për periudhën Shtator – Dhjetor do të

paguante një detyrim në vlerën 43 200 lekë. Pra këto dy faktorë të përmendur bënë të pamundur realizimin e kësaj tarife.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit tarifë së lejë përdorimi kantina për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë lejë përdorimi kantina	948 600	1 081 351	824 450	915 100	787 970




TARIFË PËR EKSPOZIM MALLI JASHTË DYQANIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
30	Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit	1 200 000	1 461 000	122 %

Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit për vitin 2015 është planifikuar 1 200 000 lekë dhe është realizuar në masën 122 % ose në vlerën 1 461 000 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë, si rezultat i punës së kryer nga inspektorët të cilët kanë inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet ekspozuese të mallit jashtë dyqanit si dhe në ndjekjen e arkëtimit të kësaj tarife brenda afateve të përcaktuara.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për ekspozim malli jashtë dyqanit për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit	843 264	981 150	714 750	1 120 100	1 461 000




TAKSË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
31	Taksë për zënien e hapësirave publike	550 000	637 434	116 %

Taksë për zënie hapësire publike për vitin 2015 është planifikuar 550 000 lekë dhe është realizuar në masën 116 % ose në vlerën 637 434 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë, si rezultat i punës së kryer nga inspektorët të cilët kanë inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet për zënien e hapësirave publike si dhe në ndjekjen e arkëtimit të kësaj tarife brenda afateve të përcaktuara.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës për zënie hapësire publike për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015 :

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Taksë për zënien e hapësirave publike	0	283 457	355 005	447 965	637 434




TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
32	Taksa mbi tokën bujqësore	800 000	896 479	112 %

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2015 është planifikuar 800 000 lekë dhe është realizuar në masën 112 % ose në vlerën 896 479 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë për detyrime të pambledhura nga vitet e mëparëshme por si dhe në ndjekjen e arkëtimit të kësaj tarife brenda afateve të përcaktuara të detyrimeve për vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi tokën bujqësore për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Taksa mbi tokën bujqësore	0	3 760 957	439 137	949 248	896 479



Më poshtë nëpërmjet tabelës po japim trendin e realizimit të taksës mbi tokën bujqësore për Njësitë Administrative për 6-mujorin e dytë 2015 :

Njësitë Administrative	Planifikimi 2015 6 - mujori	Realizimi 2015 6 - mujori	Përqindja
Njësia Administrative Mollaj	1 100 000	1 681 180	153%
Njësia Administrative Vithkuq	360 000	467 967	130%
Njësia Administrative Bulgarec	2 260 000	3 217 600	142%
Njësia Administrative Drenovë	1 125 000	2 083 783	185%
Njësia Administrative Voskopojë	47 000	384 194	817%
Njësia Administrative Voskop	6 576 980	1 343 900	20%
Njësia Administrative Lekas	2 058 053	1 400	%

TAKSË E PËRKOHSHME PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE (TELEFONI, ENERGJI, TV KABLLOR, INTERNET)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
34	Taksë e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore	2 496 000	0	0 %

Taksa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 2 496 000 lekë dhe gjatë vitit 2015 nuk ka pasur asnjë arkëtim për këtë taksë, por duhet theksuar se është bërë e mundur arkëtimi i vlerës 1 872 000 lekë nga subjekti AlbTelekom detyrime këto deri në fund të vitit 2014 dhe është bërë e mundur sigurimi në bankë i detyrimit të vitit 2015.

TË ARDHURA NGA QERATË (BANESAT SOCIALE)


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
35	Të ardhura nga qeratë (banesa sociale)	6 661 716	6 471 760	97 %

Të ardhurat nga qeratë, (banesa sociale) për vitin 2015 është planifikuar 6 661 716 lekë dhe është realizuar në masën 97 % ose në vlerën 6 471 760 lekë. Në arkëtimin prej 6 471 760 lekë të qerave nga banesat sociale të ndërtuara me bashkëfinancim dhe nga kredia me CEB, kemi arkëtuar dhe detyrime të prapambetura nga viti 2013 në masën 53 543 lekë.

Për sa më sipër, ju sqarojmë se shumë prej qerave të muajit Dhjetor nuk është bërë e mundur arkëtimi i tyre brenda vitit 2015 duke krijuar kështu diferencë nga planifikimi i qerave të banesat sociale me CEB.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të ardhura nga qeratë (banesa sociale) për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Të ardhura nga qeratë (banesa sociale)	0	0	0	3 587 703	6 471 760




TË ARDHURA NGA QERATË (BANESA NË PRONËSI TË BASHKISË ENTI I BANESAVE)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Përqindja
36	Të ardhura nga qeratë (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave)	5 293 328	3 743 702	71 %

Të ardhurat nga qeratë, (banesa në pronësi të Bashkisë enti i banesave) për vitin 2015 është planifikuar 5 293 328 lekë dhe është realizuar në masën 71 % ose në vlerën 3 743 702 lekë. Për sa më sipër realizimi në masën 71% i të ardhurave nga qeratë e banesave sociale të dorëzuara nga EKB ka arsye të vetme faktin që kanë mbetur pa nënshkruar kontratën si rrjedhojë dhe pashlyer detyrimet 5 familje të cilave ju kemi evidentuar problematikën nga mbivendosje pronësie, vendime gjyqate të pazbatuara, pretendime për status të përndjekuri dhe kompesim prone. Në arkëtimin prej 3 743 702 lekë nga EKB përveç qerasë korente janë arkëtuar dhe detyrime të prapambetura prej vitit 2013 në masën 817 000 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të ardhura nga qeratë (banesa në pronësi të Bashkisë enti i banesave) për vitet 2011 – 2012 – 2013 – 2014 dhe 2015:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Të ardhura nga qeratë (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave)	0	0	0	4 678 958	3 743 702



REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË BASHKISË PËR VITIN 2015

Shpenzime për paga

Shpenzimet për paga për punonjësit e administratës së Bashkisë, NJA dhe Institucioneve të Varësisë janë realizuar në bazë të VKM nr. 586 datë 17.7.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619 dt. 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, VKM nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.

Numri i punonjësve të administratës së Bashkisë për vitin 2015 ka qënë 112.

Numri i punonjësve të Njësive Administrative për vitin 2015 ka qënë në total 159.

NJ.A. Voskopojë	14 punonjës
NJ.A. Voskop	31 punonjës
NJ.A. Vithkuq	14 punonjës
NJ.A. Bulgarec	35 punonjës
NJ.A. Drenovë	37 punonjës
NJ.A. Mollaj	22 punonjës
NJ.A. Lekas	6 punonjës

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2015 ishte në vlerën 85,224 mijë lekë. Nga këto 69,739 mijë lekë fondi i planifikuar për bashkinë dhe 15,485 mijë lekë fondi i planifikuar për paga për Njësitet Administrative. Realizimi për vitin 2015 ka qënë në vlerën 75,371 mijë lekë ose 88.4%, nga këto 58,358 mijë lekë realizimi për Bashkinë dhe 17,013 mijë lekë realizimi i fondit të pagave për Njësitet Administrative. Vlera prej 40 mijë lekësh është detyrim nga vitit 2015, e cila do të shlyhet gjatë vitit 2016 nga fondi tranzitor.

Fondi i planifikuar për paga në programin e shërbimeve publike për NJ.A. ka qënë në vlerën 7,961 mijë lekë. Realizimi ka qënë në vlerën 6,222 mijë lekë ose 78%.

Në zbatim të VKM nr.929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” të ndryshuar, si dhe sipas Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë fondi i veçantë u përdor edhe për:

-117 mijë lekë për zhvillimin e aktivitetit me rastin e 8 Marsit.

-110 mijë lekë ndihmë për fatkeqësi për tre punonjës.

Shpenzime për sigurime shoqërore

Fondi i planifikuar për vitin 2015 ka qenë në vlerën 15,195 mijë lekë dhe konkretisht për Bashkinë 11,371 mijë lekë dhe 3,824 mijë lekë për Njësitë Administrative. Realizimi i këtij fondi ka qenë në vlerën 12,564 mijë lekë ose 82.7% nga të cilat 9,700 mijë lekë për Bashkinë dhe 2,864 mijë lekë për NJ.A. Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore në programin e shërbimeve publike për NJ.A. ka qenë në vlerën 1,355 mijë lekë. Realizimi ka qenë në vlerën 1,045 mijë lekë ose 77%.

Shpenzimet operative (mallra dhe shërbime)

Programi i administrimit të përgjithshëm

Fondi i planifikuar për shpenzime operative në programin e administrimit të përgjithshëm gjatë vitit 2015 ka qenë 75,044 mijë lekë nga të cilat 47,093 mijë lekë për Bashkinë dhe 27,951 mijë lekë fondi i planifikuar për shpenzime operative për Njësitë Administrative.

Realizimi i shpenzimeve operative për vitin 2015 ishte 51,575 mijë lekë ose 68.7% e detajuar si më poshtë:

38,508 mijë lekë Bashkia

13,067 mijë lekë Njësitë Administrative.

Analiza e detajuar e realizimit të shpenzimeve operative jepet në tabelën e mëposhtme.

000/lekë

SHPENZIME OPERATIVE	Det 14	Real det	PL 2015	FAKTI 12M	% E REALIZIMIT	Det 2015	F+DET	dif P- (F+D)
TELEKOM+POSTA			1,724	1,009	59%	216	1,225	499
ABONIM INTERNET ADSL			463	200	43%	14	214	249
TELEFON PA PAGESE			5	1	20%		1	4
ENERGJIA ELEKTRIKE			5,248	4,020	77%		4,020	1,228
PAGESE UJI			892	347	39%		347	545
UDHETIME DHE DIETA			1,643	1,549	94%		1,549	94
RIPARIM E PAJISJE MAKINASH			1,551	324	21%	766	1,090	461
KARBURANT MAKINA+NGROHJE	3,033	3,033	11,076	10,297	94%		10,297	779
PRODH DHE TRANSMETIM SPOTI DHE NJOFTIME	639	639	400	34	65%		34	366
PRODHIMI I REVISTES QYTETI IM			660	0	0%		0	660
MEREMETIME TE NDRYSHME			200	0	0%		0	200
SHPENZIME PRITJE			50	0	0%		0	50
MATERIALE ELEKTRIKE DHE HIDRAULIKE			625	179	29%		179	446
VEHJJE,UNIFORMA POLICIA			250	246	98%		246	4
MIREMBAJTJE UJESJELLES			797		0%		0	797
MIREMBAJTJE OBJEKTI			50		0%		0	50
MIREMBAJTJE KOMPJUTERA			130		0%		0	130

MATERIALE NDERTIMI			181		0%		0	181
BLERJE MATERIALE UJESJELLES KANALIZIME			420		0%		0	420
MEREMETIME E LYERJE			280		0%		0	280
MIREMBAJTJE PYJE KOMUNALE			400		0%		0	400
MIREMBAJTJE ZYRA			50		0%		0	50
MIREMBAJTJE NDRICIMI RRUGOR			100		0%		0	100
SIGURACION MAKINE NDERTESE DHE KONTROLL TEKNIK			795	482	61%		482	313
SHPENZIME TE TJERA	43	43	2,473	539	23%	90	629	1,844
ORGANIZIMI FESTES 8 MARSIT			117	117	100%		117	0
SHPENZIME Q.K.P. M.POTER	332	332	700	696	100%		696	4
LETER SHKRIMI FOTOKOPJIMI KANCELARI			1,010	560	55%		560	450
MATERIALE KONSUMI			534	144	27%	178	322	212
RIPARIM FOTOKOPJE DHE PAISJE TE NDRYSHME	79	79	200	153	83%		153	47
RUAJTJA E BASHKISE ETJ	256	256	4,151	3,550	86%	346	3,896	255
BOJE PRINTERI E FOTOKOPJUES			955	607	64%	131	738	217
SHPENZIME PER SHKOLLEN E MALTES	163	163	600	600	100%		600	0
VENDIME GJYQESORE			11,460	10,616	93%	54	10,670	790
REGJISTRIMI PRONAVE BASHKI			650	532	82%		532	118
BLLOQE ADMINISTRATIVE			360	255	71%		255	105
MAT PROMOCIO (FTESA, FLETEPALOSJE,KARTOLINA)			570	291	51%	248	539	31
VIJEZIMI I RRUGEVE	600	600	2,300	2,227	97%		2,227	73
SHP MIREMB E PROGRAMIT TE MENAXHIMIT TE TAKSAVE			480	480	100%		480	0
VLERESIMI I NDIKIMIT MJEDISOR			400	30	8%	11	41	359
APLIKIMI I ARM			607	390	64%		390	217
SHPERBLIM PER KRYETARET E FSHATRAVE			884	829	94%		829	55
SHPENZIME TRANSPORTI			410	41	10%	82	123	287
DRU ZJARRI			1,052	1,052	100%		1,052	0
QERA AMBJENTI			20	17	85%	3	20	0
QERA SHKOLLE			15		0%		0	15
FESTA E ZONES LEKAS			230	185	80%		185	45
BLERJE KLOR			40		0%		0	40
SHPENZIME NGA FONDI TRANZITOR			4,944		0%		0	4,944
BLERJE LIBRA TEKNIKE PER URBANISTIKE			70		0%		0	70
SHPENZIME PER QENDER KOM PER TE MOSHUARIT p sociale	90	90			100%		0	0
SHPENZIME PER QENDER KOM PER TE MOSHUARIT QERA AMBIENTI	100	100			100%		0	0
TOTAL SHPENZIME OPERATIVE	5,335	5,335	63,222	42,599	70%	2,139	44,738	18,484
Projekte			6,487	3,641	56%	248	3,889	2,598
SHER TE PRINTIMIT DHE PUBLIKIMIT			398	362	91%		362	36
SHPENZIME PRITJE PERCJELLJE			153		0%		0	153
SHPENZIME QERAMARRJE AMBIENTI			3,012	1,504	50%	153	1,657	1,355
SHPENZIME QERAMARRJE TE TJERA			1,000	947	95%		947	53
SHPENZIME QERAMARRJE APARATE DHE PAISJE			120	120	100%		120	0
SHPENZIME TE TJERA			592	175	30%	13	188	404
SHPENZIME HONORARE			12		0%		0	12
SHPENZIME ENERGJI DHE UJE			1,200	533	44%	82	615	585
TOTALI SHPENZIME OPERATIVE+PROJEKTE	5,335	5,335	69,709	46,240	69%	2,387	48,627	21,082

Siç shihet nga tabela e mësipërme realizimi i shpenzimeve operative vetëm për vitin 2015 është në masën 69 % dhe vlera prej 2,387 mijë lekë përbën detyrim të vitit 2015 të cilat do të mbarten në vitin 2016 dhe do të shlyhen në buxhetin e po këtij viti. Në fund të vitit 2015, në buxhetin e vitit 2015 u miratua dhe fondi prej 4,944 mijë lekë detyrime të NJ.A. nga fondi tranzitor, të cilat do të shlyhen gjatë vitit 2016, të detajuar si më poshtë:

Kod_ Artikulli	Emertimi	Vlera
		01110
6020000	Shërbim interneti	97,000
6020000	Raport VNM përroi Voskop, shk 9 vj Dërsnik	48,000
6020000	Shtypshkrime	22,416
6020000	Blerje klor	16,800
6020000	Materiale për mirembajtje automjetet	85,026
6020000	Pjesë kembimi automjetet	115,920
6020000	Mirëmbajtje kompjuteri	51,400
6020000	Mirëmbajtje automjeti	98,000
6020000	Blerje cemento	100,000
6020000	Ftesa	31,000
6020000	Printime	5,220
6020000	Mjete pune	13,650
6020000	Bojra	5,300
6020000	VNM sistemim përroi	60,000
6020000	Këshilltarët	767,732
6020000	Detyrime në tatimet	592,562
6020000	Zënie tregu	11,638
6020000	Blerje karburanti	1,565,500
	Total	3,687,164
	Total NJ.A. Voskop	3,687,164.00
6020000	Shpenzime mirëmbajtje kompjuteri	36,700
6020000	Shërbime postare	792
6020000	SHA ujësjelles fshat shkolla Lumalas	900
6020000	Fature uji Maj 2015	56,112
	Total NJ.A. Bulgarec	94,504
6020000	Qera për shkollën	15,000
6020000	Vendime gjyqësore	560,000
6020000	Shpenzime dru zjarri	138,000
6020000	Shpenzime transporti	168,000
	Total NJ.A. Lekas	881,000
6020000	Aplikim prane ZRPP	259,000
6020000	Shp telefonike Plus Communication	22,297
	Total NJ.A. Drenovë	281,297
	TOTAL	4,943,965

Programi i arsimit parauniversitar për NJ.A.

Në buxhetin e Bashkisë të vitit 2015 u planifikuan edhe shpenzimet në arsim në vlerën 6,764 mijë lekë dhe realizimi i shpenzimeve ka qenë në vlerën 6,252 mijë lekë ose 92% dhe paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

SHPENZIME OPERATIVE	Pl 2015	Fakti 12M	% e Realizimit
DRU ZJARRI	3,258	3,254	100%
MIREMBAJTJE OBJEKTI	562	559	99%
MEREMETE DHE LYERJE	2,334	2,046	88%
ENERGJIA ELEKTRIKE	50	23	46%
LETET SHKRIMI FOTOKOPJIMI KANCELARI	45		0%
MATERIALE KONSUMI	340	269	79%
MATERIALE TE TJERA	106	93	88%
UJI I PIJSHEM CIFLIG	56		0%
KONSUMI I UJIT	13	8	62%
TOTAL SHPENZIME 09120	6,764	6,252	92%

Programi i shërbimeve publike për NJ.A.

Fondi i planifikuar për shpenzime për paga për punonjësit e shërbimit për vitin 2015 për NJ.A. ka qenë 7,961 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 6,222 mijë lekë ose 78%.

Fondi i planifikuar për shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e shërbimit të NJ.A. për vitin 2015 ka qenë 1,355 mijë lekë dhe realizuar për shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ka qenë 1,045 mijë lekë.

Në buxhetin e Bashkisë të vitit 2015 gjithashtu u planifikuan edhe shpenzimet në shërbimet publike në vlerën 1,656 mijë lekë dhe realizimi i shpenzimeve ka qenë në vlerën 256 mijë lekë ose 15% dhe paraqitet si më poshtë:

SHPENZIME OPERATIVE	PL 2015	Fakti 12M	% e Realizimit
ENERGJIA ELEKTRIKE	598	256	43%
SHPENZIME TE TJERA	108		0%
KLOR PER DEPOT E UJIT	50		0%
RRETHIM VARREZAT MALAVEC			
KULLIM KANALE KULLUES BRENDA TERRITORIT Të KOMUNës	300		0%
SISTEMIM SHTRIM ME ÇAKULL	400		0%
BLERJE TUBO	200		0%
TOTAL SHPENZIME 06260	1,656	256	15%

HUAMARRJA VENDORE (KREDIA)

Në buxhetin e vitit 2015 është shlyer kredia e financuar nga Ministria e Financave, Pro Credit bank, Intesa San Paolo.

- Sipas kontratës së lidhur midis Bashkisë Korçë dhe **Pro Credit Bank** me nr. 777 Rep dhe nr. 432/2 Kol date 31.3.2010. Bashkia ka shlyer kredinë të detajuar si më poshtë:

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë gjatë vitit 2010 është: principali në vlerën 45.000.000 lekë dhe interesi në vlerën 19,041,429.67 lekë.

Për shlyerjen e këtij disbursimi është paguar për periudhën 2010-2015 vlera prej 15,249,955.85 lekë (interesi) dhe principali në vlerën 19,222,848.88 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë gjatë vitit 2011 është: principlali në vlerën 23,800,000 lekë dhe interesi në vlerën 9,597,996.21 lekë.

Për shlyerjen e disbursimit të dytë është paguar për periudhën 2011-2015 vlera prej 7,165,111.5 lekë (interesi) dhe principlali në vlerën 9,083,004 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e tretë të kredisë gjatë vitit 2012 është: principlali në vlerën 23.800.000 lekë dhe interesi në vlerën 8,911,653.56 lekë.

Për shlyerjen e disbursimit të tretë është paguar për periudhën 2012-2015 vlera prej 5,163,119.89 lekë (interesi) dhe principlali në vlerën 5,909,087.12 lekë.

- Gjatë vitit 2014 me VKB është miratuar kredia në vlerën 200,000 mije lekë, midis Bashkisë Korçë dhe **Intesa Sanpaolo Bank**, ku është nënshkruar dhe kontrata me nr 977rep/nr 928 Kol.datë 15.05.2014. Duke ju referuar kontratës dhe planin e pagesave po ju paraqesim dhe shlyerjen e kësaj kredie si më poshtë:

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë gjatë muajit Tetor 2014 është: principlali në vlerën 50.000.000 lekë dhe interesi në vlerën 16,606,549,31 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Shkurt- Dhjetor 2015 është paguar interes në vlerën 2,767,918 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë gjatë muajit Dhjetor 2014 është: principlali në vlerën 100.000.000 lekë dhe interesi në vlerën 33,191,671.18 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Shkurt- Dhjetor 2015 është paguar interes në vlerën 5,535,833.33 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e tretë të kredisë është: principlali në vlerën 50.000.000 lekë dhe interesi në vlerën 16,203,793.5 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Mars - Dhjetor 2015 është paguar interes në vlerën 2,085,418.67 lekë.

- Në bazë të marrëveshjes së nën-huasë së nënshkruar midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga **Ministria e Financave** dhe Bashkisë Korçë datë 13.02.2008 për projektin “Ndërtimi i Banesave me Qëllim Social”, shlyerja e kredisë e financuar nga CEB paraqitet si më poshtë:
- ✓ Transhi i parë 2014-2023 shuma e disbursuar është 340,214 euro.
- ✓ Transhi i dytë 2016-2025 shuma e disbursuar është 640,000 euro.
- ✓ Transhi i tretë 2017-2026 shuma e disbursuar është 110,000 euro.
- ✓ Transhi i katër 2018-2027 shuma e disbursuar është 101,386 euro.

Shuma e shërbimit të borxhit për transhin e parë të kredisë është: principlali në vlerën 340,214 euro. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Dhjetor 2014- Dhjetor 2015 është paguar principlali në vlerën 9,480,875 lekë.

Realizimi i kredisë për vitin 2015 jepet si më poshtë:

	Pl 2015	Fakt 2015
SHLYERJA E KREDISË 2015	28,085	27,905
INTERESI	14,398	14,241
PAGESË PRINCIPALI	13,687	13,664

Transferta tek organizatat

Fondi i planifikuar për transfertat tek organizatat e ndryshme ka qenë në vlerën 33,325 mijë nga të cilat Kontributi i Qarkut ishte në vlerën 13,468 mijë lekë dhe 19,857 mijë lekë transfertat tek organizatat.

Realizimi i transfertës në total për vitin 2015 ka qenë 22,317 mijë lekë ose 67% nga të cilat 4,700 mijë lekë Kontributi i Qarkut dhe 17,617 mijë lekë transfertat, të paraqitura si më poshtë:

000/lekë

	Det 2014	Real det 2015	PL 2015	FAKTI 12m	% E Real
TRANSFERIMET	10,534	5,175	27,174	17,579	60%
TRANSFERTA TEK ORGANIZATAT	10,534	5,175	22,791	17,143	67%
AGJENTI TATIMOR ALBEN 2 SECURITY	432	432	7,141	6,938	97%
TRANSFERTË PER UKK KORÇË			5,000	5,000	100%
KONTRIBUT I BASHKISË PËR KRWM			3,000	2,000	67%
TRANSFERIME SIPAS PROJ FËMIJËT NË NEVOJË	27				0%
MBËSHTETJE PËR PERSONAT E VETMUAR DHE MOSHUAR	32				0%
KOMISION PËR TATIMIN E THJESHTUAR TË BIZNESIT TË VOGËL	43	43	800	544	70%
TRANSFERTA NGA NJA			3,161		0%
PAGESA PËR SHOQATËN BID			489	489	100%
KONTRIBUTI I QARKUT	10,000	4,700	1,000		43%
KONT FINANCIAR PËR TVSH PËR PROJEKTET E KE			2,200	2,172	99%

Në fund të vitit 2015, në buxhetin e vitit 2015 u miratua dhe fondi prej 237 mijë lekë detyrime të NJ.A. dhe Bashkisë, nga fondi tranzitor dhe nga të ardhurat e Bashkisë, të cilat do të shlyhen gjatë vitit 2016, të detajuar si më poshtë:

Kod_ Artikulli	Emërtimi	Vlera
		01110
6040000	Kontributi për Ujesjellës fshat për energjinë	229,375
6040000	Tatim taksa det ndaj shtetit	939
	Total Voskop	230,314
6040000	Tatim i thjeshtuar biznesi i vogël	6,326
	Total Bashkia	6,326
	TOTAL	236,640

Transferta tek individët

Fondi i planifikuar për transfertat tek individët ka qenë në vlerën 4,383 mijë lekë dhe realizimi shkoi në vlerën 436 mijë lekë ose 10% dhe konkretisht:

000/lekë

	PL 2015	Fakti 12 m	% e real	Det 2015	F+Det
TRANSFERTA TEK INDIVIDËT	4,383	436	10%	3,804	3,804
TRANSFERTA TEK INDIVIDËT	279	279	100%		
TRANSFERTA NË RAST FATKEQËSIE	300	130	43%		
NDIHME FIN PËR FAMILJET NË NEVOJË	1,404		0%	1,404	1,404
PAGESA PËR QYTETARIN V.TOMORI	15	15	100%		
PAGESA PËR QYTETARIN A. MILO	12	12	100%		
BONUS STREHIMI PËR QYTETARËT	2,373		0%	2,400	2,400

Vlera prej 3,804 mijë lekë do të planifikohet në buxhetin e vitit 2016.

Fondi i emergjencave civile

Fondi i planifikuar për emergjencat civile për vitin 2015 ka qenë në vlerën 604 mijë lekë dhe konkretisht 500 mijë lekë të planifikuara nga Bashkia dhe 104 mijë lekë nga Njësitë Administrative. Ky fond u realizua në vlerën 435 mijë lekë, ndihmë financiare për familje të dëmtuara nga zjarri dhe konkretisht:

- 100 mijë lekë familja e M. Pino
- 215 mijë lekë familja e A. Cicani, M. Spaho
- 80 mijë lekë familja e S. Najtre NJ.A. Vithkuq
- 40 mijë lekë familja e H. Llapanji NJ.A. Lekas

Këshilltarët

Planifikimi për pagesën e këshilltarëve gjatë vitit 2015 ka qenë në vlerën 5,025 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 5,012 mijë lekë.

SHËRBIMET PUBLIKE

1. **Shërbimi i transportit qytetës** gjatë vitit 2015 u planifikua me një vlerë 7,000 mijë lekësh dhe jepet në formë subvencioni. Realizimi ka qenë në vlerën 6,982 mijë lekë. Ky shërbim mbështetet në realizimin e zërave të mëposhtëm :

- a. Itenerari i përcaktuar në kontratë i mjeteve.
- b. Orari i shërbimit të këtij transporti.
- c. Numri i mjeteve në linjë.
- d. Fluksi i kalimit të autobusëve nëpër stacionet e përcaktuara.
- e. Qëndrimi i mjeteve nëpër stacionet e përcaktuara.

2. **Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe ato të dëshmorëve**

Fondi i planifikuar për vitin 2015 ka qenë 4,156 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 4,041 mijë lekë ose në masën 97.2%. Ky shërbim konsiston në zërat e mëposhtëm:

- a. Pastrim parcelash, rrugë dhe sheshe të brendshme ndërmjet blloqeve të varrimit
- b. Mirëmbajtje drurë dhe shkurre dekorative.
- c. Mbjellje drurë dekorative.
- d. Mirëmbajtje dhe krijim gardhe të gjelbërt me ligustër dhe lavandinë.
- e. Kositje, grumbullim dhe transport bari.
- f. Mirëmbajtje bordure betoni të brendshme.
- g. Lyerje me gëlqere të bordurave dhe pemëve në varrezat publike dhe të dëshmorëve.
- h. Ruajtja e objektit në varrezat publike dhe të dëshmorëve.
- i. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve.
- j. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve nga amortizimi.
- k. Mirëmbajtje e murit rrethues.
- l. Konsumi i ujit të pijshëm për mirëmbajtje dhe nevojat e qytetarëve.

3. Shërbimi i pastrimit të qytetit gjatë vitit 2015 ky shërbim është një nga shërbimet më të rëndësishme që kryen Bashkia në shërbim të komunitetit. Fondi i planifikuar për vitin 2015 ka qenë 109,329 mijë lekë nga të cilat 50,427 mijë lekë ishin detyrim i vitit 2014 dhe 58,902 mijë lekë fondi i planifikuar në vitin 2015, kurse realizimi ka qenë në vlerën 81,611 mijë lekë dhe konkretisht 50,427 mijë lekë detyrim i vitit 2014 dhe 31,184 i planifikuar gjatë vitit 2015. Realizimi ka qenë në masën 74.6%. Vlera prej 23,545 mijë lekë do të shlyhet gjatë vitit 2016.

Objekti i këtij shërbimi është:

- pastrimi i rrugëve dhe trotuareve,
- evadimi i mbetjeve urbane në qytetin e Korçës dhe përpunimi i tyre,
- lagia e rrugëve,
- evadimi i dëborës në stinën e dimrit dhe hedhja e kripës për lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe njerëzve, etj.

Pastrimi i rrugëve bëhet çdo ditë prej orës 24.00 deri 06.00. Pastrohen çdo ditë 429,861 m² rrugë dhe trotuare. Transporti i mbeturinave për në fushën e grumbullimit dhe përpunimit të tyre bëhet çdo ditë me mjete teknologjike prej orës 03.00 deri 07.00 për evadimin e mbetjeve nëpër konteniere dhe prej orës 07.00 deri 11.00 për lagjet që nuk kanë konteniere. Çdo ditë evadohen rreth 80 ton mbeturina. Lagia e rrugëve bëhet për periudhën 01.04 deri 31.10 çdo ditë nga ora 06.00 deri 18.00 në një sipërfaqe prej 295,870 m² si dhe larje speciale e rrugëve me sipërfaqe 70,236 m² çdo ditë. Grumbullimi i mbeturinave bëhet me rreth 400 konteniere.

Gjithashtu në këtë shërbim hyn edhe pagesa për supervizorin e pastrimit. Fondi i planifikuar për shpenzime për paga për vitin 2015 ka qenë 540 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 532 mijë lekë ose 98.5%.

Fondi i planifikuar ka qenë 90 mijë lekë. dhe realizuar për shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2015 ka qenë 85 mijë lekë.

ANALIZA E PROJEKTEVE 2015**Festa e Birrës 2015**

www.festaebirres.com

www.korcabeerfest.com

Përshkrim shkurtimisht:

Projekti “Festa e Birrës”, i implementuar për të nëntin vit radhazi synoi stimulimin, mbështetjen, promovimin e bizneseve lokale, dhe stimulimin e turizmit si drejtim i rëndësishëm zhvillimi për qytetin. Këtë vit, ndryshe nga vitet e kaluara festa u pozicionua në krah të Stadiumit “Skënderbeu” dhe përgjatë 5 netëve 12-16 Gusht 2015, pati një sërë aktivitete të zhvilluara, ku performuan këngëtarë të njohur dhe grupe të shquara brenda Shqipërisë dhe jashtë saj.

Gjatë pesë netëve të festës, u vu re një audience masive, jo vetëm nga qyteti i Korçës dhe rrethinat e tij, por edhe turistët vendas dhe të huaj, të ardhur posaçërisht për të ndjekur këtë event të rëndësishëm.

Realizimi i kësaj feste bëhet i mundur nga kontributi i bizneseve pjesëmarrëse dhe mbështetëse, të cilat kanë mundësi veç të tjerash të reklamojnë aktivitetin e tyre para një audience të madhe njerëzish, që kap shifrat rreth 10 mijë vetë çdo natë si edhe të jenë në vëmendjen e mediave lokale dhe kombëtare që ndjekin çdo natë ecurinë e aktivitetit.

Ky event përveç se përfaqëson një nga eksperiencat më pozitive dhe më të suksesshme të zhvillimit të turizmit, promovon gjithashtu qytetin dhe ato çka ai përfaqëson si një destinacion të rëndësishëm turistik në Shqipëri.

Vlera totale e këtij projekti nga Bashkia: **1 000 000 Lek**

Vlera e realizuar e projektit: **946 800 Lek**



Foto nga Festa e Birrës 2015

**Festa e Lakrorit****Përshkrim shkurtimisht:**

Projekti “Festa e Lakrorit 2015” u implementua edhe këtë vit në formën e një eventi që tërhoqi vëmendjen dhe pjesëmarrjen e shumë vizitorëve, duke konsoliduar profilin festiv të kësaj tradite. Festa e Lakrorit këtë vit ndryshe nga vitet e kaluara, u zhvillua në fshatin

Boboshticë në datën 31 Korrik 2015, me qëllim gjallërimin e jetës turstike si edhe ruajtjen e traditës së gatimit tradicional edhe në atraksionet turistike që i bashkangjiten qytetit të Korçës në kuadrin e ndarjes së re administrative territoriale. Për realizimin e këtij projekti me të gjithë komponentët e nevojshëm, fituesi i tenderit siguroi gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e aktivitetit, duke zbatuar me përpikmëri të gjitha specifikimet e tenderit. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin 4 taverna, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Boboshticë: Rosicat, Vila Melko, Taverna Antoneta dhe taverna Tomas, të cilat tregëtuhan jo vetëm lakror, por edhe gatime të tjera tradicionale. Gjithashtu në festë mori pjesë edhe pastičeri Nefeli, e cila tregëtoi për të pranishmit ëmbëlsira dhe akulllore. Gjatë festës amvisat demonstuan bërjen e lakrorit si edhe pjekjen në sac duke plotësuar kërkesat e pjesëmarrësve në festë. Gjatë gjithë aktivitetit, nuk munguan edhe tingujt e serenatave korçare, duke gjallëruar akoma më shumë atmosferën festive. Pjesëmarrësit në këtë festë ishin të shumtë, rreth 1000 persona, nga të cilët shumica ishin qytetarë të Korçës që kihin erdhur në Boboshticë enkas për festë. Nuk mungonin edhe vizitorë vendas dhe të huaj. Impakti që kjo festë pati në Boboshticë ishte pozitiv, pasi të gjitha tavernat në Boboshticë ishin të frekuentuara maksimalisht. Gjatë festës, u shpërndanë edhe materiale promocionale të qytetit.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **145 000 Lek**

Vlera e realizuar e projektit: **144 240 Lek**



Foto nga aktiviteti festa e lakrorit



Respekt për mësuesit

Përshkrim shkurtimisht:

Me rastin e 7-Marsit, festës së mësuesve, Bashkia Korçë zhvilloi në ambientet e Muzeut Kombëtar të Arsimit “Mësonjëtorja e Parë Shqipe” një pritje koktej me mësues korçarë, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në edukimin e brezave. Mësuesve pensionistë, të cilët ishin të pranishëm në aktivitet, iu dhuruan lule në shenjë mirënjohjeje. Në pritjen e nderit, Kryetari i Bashkisë përcolli urimet dhe falenderimet për kontributin e jashtëzakonshëm të mësuesve korçarë në vite, të cilët punuan gjithë jetën në këtë profesion kaq të dashur duke edukuar me profesionalizëm, përkushtim dhe fisnikëri disa gjenerata.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **100 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **90 600 Lek**



Bursa për gjimnazistët

Përshkrim shkurtimisht:

Bashkia e Korçës vazhdon të zbatojë çdo vit projektin “Bursa për gjimnazistët”, i cili synon stimulimin e nxënësve dhe nxitjen e tyre për të arritur rezultate të shkëlqyera. Duke qënë një program social-arsimor, përfitues janë nxënësit me të gjitha notat 10 për vitet e njëmbëdhjeta, të dymbëdhjeta në të gjitha shkollat e mesme publike dhe jopublike të qytetit të Korçës.

Projekti “Bursa për gjimnazistët” ka si synim jo vetëm vlerësimin moral, por edhe material të gjimnazistëve me të gjitha notat dhjeta, në formën e një burse mujore, e cila shërben si një formë e re nxitjeje për nxënësit me qëllim arritjen e rezultateve me të larta, duke e kthyer arsimimin në një prioritet të tyre.

Drejtoria Rajonale e Arsimit bashkëpunoi me të gjithë shkollat e mesme në qytet për dhënien e emrave të nxënësve të shkëlqyer të vitit akademik 2014-2015, të cilët janë përfitues direktë të projektit.

Bashkia Korçë në datën 24 Nëntor 2015, ora 18:00 në ambientet e Muzeut Kombëtar të Arsimit “Mësonjëtorja e Parë Shqipe”, Korçë u organizua ceremonia e shpërndarjes së certifikatave për nxënësit me të gjitha notat dhjeta nga pesë gjimnazet publike dhe jopublike të qytetit. Nxënësit e shkëlqyer u vlerësuan nga kryetari i Bashkisë me certifikata dhe për të gjithë të pranishmit në fund të aktivitetit u shërbye një koktej.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **1 121 000 Lek.**

Ky projekt është në vazhdimësi dhe perfundon në fund të vitit kalendarik shkollor Qershor 2016.



Foto nga Ceremonia e shpërndarjes së certifikatave për gjimnazistët e shkëlqyer

Kalendari i Aktiviteteve 2015

Përshkrim shkurtimisht:


Bashkia Korçë, me qëllim promovimin e aktiviteteve social- kulturore e turistike të qytetit, promovimin e muzeumeve dhe atraksioneve turistike të rajonit si edhe për të pasur një paketë informuese për vizitorët vendas dhe të huaj që vizitojnë qytetin, realizoi Kalendarin e Aktiviteteve 2015, i cili përmbledh paketën e plotë të eventeve të rajonit të Korçës.

Pas konfirmimit të datave të sakta të aktiviteteve, u konceptua draft kalendari, i cili përfshinte përshkrimet e aktiviteteve, datat përkatëse si edhe foto të aktiviteteve. Pas konfirmimit të draftit final për këtë projekt, u realizua printimi i kalendarit nga kompania fituese e tenderit.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga

Bashkia: **70 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **46 800 Lek**



Pjesëmarrje në Panaire Kombëtare dhe Ndërkombëtare Festivali i Ushqimit dhe Pijeve “Mediterran”

Përshkrim shkurtimisht:

Bashkia Korçë mori pjesë në Festivalin e Ushqimit dhe Pijeve “Mediterran”, organizuar nga Expocity Albania në bashkëpunim me Çelësi Media Group në Tiranë prej datës 12-15 Nëntor 2015. Ky aktivitet kishte për qëllim promovimin e produkteve, traditës, risitë dhe inovacionin në fushën e prodhimit e përpunimit agro- ushqimor si dhe gatimit në rajonin e Mesdheut. Në Festivalin e Ushqimit dhe Pijeve u përfaqësuan përgjatë katër ditëve, më të mirat e produkteve të ushqimit dhe pijeve, specialitetet e gastronomisë dhe kulinarisë, përfaqësues të zonave, bashkive apo komunave karakteristike që duan të shpalosin traditën e tyre, biznese nga të voglat deri te rajonalet dhe ata që tregtojnë ndërkombëtarisht.

Në festival merrnin pjesë Bashkia Tiranë, Elbasan, Berat, Komuna Zallher, Komuna Shëngjergj, si edhe një sërë biznesesh të njohura si vaji Olim, Mon Caffè, kafe Lavazza, Kantina e Pijeve “Skënderbeu”, fabrika e përpunimit të qumështit “Lufra”, Birra Peja, Uji Tepelena, etj. Festivali i Ushqimit dhe Pijeve “Mediterran” ishte një ndërthurje unike e ushqimit, pijeve, gatimit dhe teknikave të prodhimit dhe përpunimit të tyre, si nga prodhues industrial ashtu edhe nga ata artizanale. Vende, zona e krahina paraqitën në këtë panair, traditat e tyre më të spikatura e origjinale në produkte dhe kulinari.

Gjatë katër ditëve në këtë festival, kishe mundësi të shihje më të mirën nga prodhimet lokale, rajonale dhe ndërkombëtare, furnizuesit e hotelarisë, prodhuesit e pijeve dhe prodhuesit e ushqimit. Ky festival ishte një mundësi, në kohën e duhur, për të promovuar produktet e veçanta, i cili shfaqti interes dhe pati një impakt pozitiv për të gjithë të ftuarit

të cilët ishin informuar për ta vizituar. Festivali, gjithashtu u vizitua përgjatë katër ditëve, nga një numër i madh vizitorësh vendas dhe të huaj, të cilët shijuan produktet e veçanta, të ekspozuara në çdo stendë.

Vlera totale e projektit "Pjesëmarrje në Panaire Kombëtare dhe Ndërkombëtare": **500 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **83 817 Lek**



Foto stenda e Bashkisë Korçë

Panairi i Punës dhe Punësimi Sezonal

Përshkrim shkurtimisht:

Bashkia Korçë në kuadrin e programit "Qyteti mbështet të Rinjtë", në bashkëpunim me Universitetin "Fan S. Noli", Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Korçë, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (DRSHKP), Korçë organizuan në datën 29 Prill, ora 11:00 tek biblioteka "Thimi Mitko", Korçë Panairin e Punës 2015. Ky projekt synon të ofrojë mundësi punësimi për të gjithë të rinjtë që kanë përfunduar arsimin e lartë dhe të mesëm, në biznese lokale, banka dhe institucione të tjera, të cilat ofrojnë vende të lira pune me kohë të plotë ose të pjesshme. Përzgjedhja e kandidatëve për vendet e lira të punës, u realizua përmes intervistimit të të rinjve nga institucionet, që morën pjesë në këtë projekt.

Në fillim të muajit Gusht 2015, pas përzgjedhjes nga Panairi i Punës të studentëve që do të kryejnë praktikë profesionale në drejtoritë e ndryshme të Bashkisë Korçë, u realizua Punësimi Sezonal. Qëllimi i këtij projekti është angazhimi i studentëve në punë konkrete dhe vënia në praktikë e njohurive të fituara nga arsimimi i tyre. 44 studentët e përzgjedhur për të qenë pjesë e Punësimit Sezonal pranë Bashkisë Korçë, u vendosën sipas profilit të tyre të studimit në drejtori të ndryshme pranë Bashkisë Korçë dhe kryen praktikë për një periudhë një mujore në këto drejtori.

Vlera totale e projektit: **50 000 Lek**

Vlera e realizuar e projektit: **47 880 Lek**



Foto nga Panairi i Punës 2015

Çanta suveniresh

Përshkrim shkurtimisht:

Me qëllim nderimin e delegacioneve dhe personaliteteve të tjerë të rëndësishëm që vizitojnë qytetin e Korçës, Bashkia Korçë ka realizuar çantat e suvenireve, si një material promocional dhe përfaqësues, në të cilën vendosen të gjitha materialet e tjera promovuese të qytetit (guida, kalendar aktivitetesh, hartë e qytetit, etj). Realizimi i një çante të tillë e stampuar me elemente simbolike të qytetit, përfaqëson një material promocional shtesë, krahas materialeve të tjera promovuese të realizuara gjatë vitit 2015.



Vlera totale e projektit: **50 000 Lek**

Vlera e realizuar e projektit: **45 000 Lek**

Festa e 1 Qershorit

Përshkrim shkurtimisht:

Bashkia Korçë, me rastin festës së fëmijëve organizoi edhe këtë vit një sërë aktivitetesh social-kulturore. Festa e 1 Qershorit u realizua në ambientet e parkut “Rinia”, ku u zhvilluan një sërë aktivitetesh si:

- Koncert festiv, organizuar nga Qendra Kulturore e Fëmijëve “Mihal Grameno”,
- Serenatistët e vegjël.
- Kërcime nga grupet e aerobisë.
- Fëmijet e ndryshëm të veshur si personazhe përallash.
- Këndi i vizatimit.
- Ekspozitë vizatimesh nga fëmijët e kopsheve dhe klasave fillore të qytetit.
- Lojra të ndryshme të organizuara nga Fusion dhe Kenedi .
- Lojra të ndryshme nga ekipi i të rinjve të karatesë .
- Lojra të ndryshme nga ekipi i badmintonit .

Të gjithë fëmijët e qytetit të shoqëruar nga prindërit festuan Festën e 1 Qershorit në atmosferën festive të krijuar enkas për ta.

Festa vazhdoi gjatë orëve të pasdites në Zonën Këmbësore të qytetit, ku u zhvilluan lojëra të ndryshme për fëmijët nga Fondacioni Kenedi dhe grupe animatorësh, të shoqëruara me muzikë.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **95 200 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **95 200 Lek.**



Dita Ndërkombëtare e PAK **Përshkrim shkurtimisht:**

Me rastin e 3 Dhjetorit “Ditës Ndërkombëtare të Personave me aftësi të kufizuar”, u realizua projekti “Dita Nderkombetare e PAK”, me tematikë “Festojmë së bashku”. Aktiviteti u zhvillua në ambientet e hotel “Grand” dhe salla ku u zhvillua aktiviteti u zbukurua me tullumbace shumëngjyrëshe, duke e bërë më të ngrohte dhe festive ambientin. Përmes koncertit të organizuar nga Qendra Kulturore e Fëmijëve “Mihal Grameno”, u krijua një ambient tepër festiv, ku të gjithë personat me aftësi të kufizuar festuan së bashku. Në aktivitet morën pjesë rreth 100 persona nga institucione dhe OJF që kanë në fokus të punës së tyre aftësinë e kufizuar. Në fund të gjithë aktiviteteteve të organizuara me sukses, u ofrua një koktej për personat e pranishëm.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia **59 500 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **59 500 Lek.**



Dita e të Drejtave të Fëmijëve

Përshkrim shkurtimisht:

Nëpërmjet projektit të 20 Nëntorit “Ditës së të Drejtave të Fëmijëve”, të gjithë fëmijët e shkollave 9-vjeçare të qytetit u njohën më mirë, me të drejtat dhe detyrat që ata kanë. Në qendër të qytetit u vendosën dy banera për Ditën e të Drejtave të Fëmijëve.

Përmes aktiviteteve të ndryshme sensibilizuese, u përcoll mesazhi për t'i thënë stop punës së të miturve. Gjithashtu në këtë ditë u realizua një ekspozitë nga shkollat 9-vjeçare të qytetit të Korçës, me te gjitha nenet e konventës për të drejtat e fëmijëve.

Fëmijët u argëtuan nëpërmjet aktiviteteve sportive, si edhe lojrave argëtuese të zhvilluara enkas për ta nga Fondacioni “Kenedi”.

Me rastin e kësaj dite u zhvillua një koncert i madh artistik me këngëtare të ndryshëm, grupe vallesh dhe grupe animatoresh për fëmijë.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **79 500 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **79 500 Lek.**



Dita e Jetimëve

Përshkrim shkurtimisht:

Në kuadër të projektit të 20 Majit “Ditës Ndërkombëtare të Jetimeve” u organizuan një sërë aktiviteteve.

Për realizimin e këtij aktiviteti, u dizenjua dhe u realizua një baner, i cili u vendos në zonen këmbësore të qytetit dhe një baner tjetër në ambientet e lokal “Omega”.

Gjatë paradites së 20 Majit, në orën orën 11:00, Kryetari i Bashkisë i shoqëruar nga një pjesë e stafit të Bashkisë bëri një vizitë në shtëpinë e foshnjës “Lulet e vogla”, ku bashkë me fëmijët e qendrës u kaluan disa orë duke u argëtuar së bashku në një kënd lojrash.

Me rastin e kësaj dite, Kryetari i Bashkisë zhvilloi një takim me 250 fëmijët jetimë të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit të Korçës, në ambientet e bar “Omega”, ku u zhvillua edhe një koncert festiv nga fëmijet e qendrës kulturore të fëmijëve. Aktiviteti u përmbyll me një koktej për të gjithë të pranishmit.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **150 500 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **115 460 Lek.**

INVESTIMET 2015

Burimet kryesore të realizimit të investimeve të Bashkisë në vitin 2015, kanë qënë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, transferta e pakushtëzuar, të ardhurat e trashëguara të vitit 2014, huamarja vendore (kredia), si dhe Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

(financime nga buxheti i shtetit).

000/ lekë

SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT	Plan	Fakt	%
Kredia	176,694	158,541	89.7%
Fondi i Zhvillimit të Rajoneve	762,373	521,733	68.4%
Të ardhurat	69,126	33,161	48%
Total	1,008,193	713,435	70.7%

Sipas programeve planifikimi dhe realizimi paraqitet si më poshtë:

- ✓ infrastruktura rrugore nga të ardhurat e Bashkisë, planifikimi ka qënë 33,185 mijë lekë dhe realizimi 22,362 mijë lekë.
- ✓ infrastruktura rrugore nga huamarrja vendore (kredia), planifikimi ka qënë 60,236 mijë lekë dhe realizimi 58,211 mijë lekë.
- ✓ infrastruktura rrugore nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, planifikimi ka qënë 762,373 mijë lekë dhe realizimi 521,733 mijë lekë.
- ✓ administrim i përgjithshëm (blerje paisje), planifikimi ka qënë 3,575 mijë lekë dhe realizimi 1,578 mijë lekë.
- ✓ shërbime publike, planifikimi ka qënë 17,576 mijë lekë dhe realizimi 2,381 mijë lekë
- ✓ shërbime publike nga huamarrja vendore (kredia), planifikimi ka qënë 104,683 mijë lekë dhe realizimi 100,330 mijë lekë
- ✓ investime në kulturë, planifikimi ka qënë 3,816 mijë lekë
- ✓ investime në kulturë, nga huamarrja vendore (kredia), planifikimi ka qënë 11,775 mijë lekë
- ✓ studime urbanistike, planifikimi ka qënë 7,746 mijë lekë dhe realizimi 6,308 mijë lekë
- ✓ investime në arsim, planifikimi ka qënë 3,073 mijë lekë dhe realizimi 460 mijë lekë
- ✓ investime në banesat sociale, planifikimi ka qënë 155 mijë lekë dhe realizimi 72 mijë lekë

Realizimi i investimeve sipas programeve jepet i detajuar si më poshtë:

Infrastruktura rrugore

Gjatë vitit 2015 investimet në programin e infrastrukturës paraqiten sipas tabelave të mëposhtme:

Tabela e Investimeve financuar nga të ardhurat e Bashkisë dhe fondi tranzitor për vitin 2015

Emërtimi i objektit	Det 2014	Pl 2015	Realizimi	Det 2015
Rikonstruksion Bulevardi Shëngjergjit (Blerje pllakash)	5,586,896		5,586,896	
Rikonstruksion Sheshi para Katedrales	16,522,777		16,522,777	2,041,477
Mbikqyrje Punimesh ndërtim "Sheshi para Teatrit"	907,200			907,200
Mbikqyrje Punimesh "Rimodelim Parku Rinia"	787,200			787,200
Kolaudim Punimesh "Rimodelim Parku Rinia"	370,000			265,000
Mbikqyrje Punimesh obj Rikonstr i rrugëve në Lagj nr 6 (rrg. Asim Vokshi)	9,000		9,000	
Kolaudim Punimesh obj Rikonstr i rrugëve në Lagj nr 6 (rrg. Asim Vokshi)	22,436		22,436	
Kolaudim Punimesh ndërtim "Sheshi para Teatrit"	286,812			221,000
Mbikqyrje për "Rikualifikimin urban i blloqeve të banimit të lagjeve kryesore brenda unazës së qytetit"		601,500	123,900	33,300

Kolaudim për "Rikualifikimin urban i blloqeve të banimit të lagjeve kryesore brenda unazës së qytetit"		120,900		120,000
Mbikqyrje "Rritja e sigurisë së qytetarëve përmes monitorimit dixhital"				1,690,990
Kolaudim "Rritja e sigurisë së qytetarëve përmes monitorimit dixhital"		273,968		273,967
Mbikqyrje punimesh për ndërtimin e kompleksit multifunksional zona sportive		5,945,809		5,945,809
Mbikqyrje "Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytet"		114,000	96,900	17,100
Kolaudim "Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytet"		105,313		70,000
Mbikqyrje "Rikonstruksioni rrugës Voskopojë-Lekas"				
Kolaudim "Rikonstruksioni rrugës Voskopojë-Lekas"				
Rikonstruksion kryqëzimi rruga Voskopojë-Shipskë-Krushovë		400,000		
Rikonstruksion rruga Lavdar		200,000		
Rikonstruksion rruga Gjonomadh		200,000		
Sistemim rruga Shkozaj Gjokshtiras Fond tranzitor		336,000		336,000
Rikonstruksion kryqëzimi rruga Voskopojë -Shipskë-Krushovë fond tranzitor		394,800		394,800
Totali Infrastruktura rrugore	24,492,321	8,692,290	22,361,909	13,103,843

Vlera prej 13,104 mijë lekësh përbën detyrim i cili do të shlyhet gjatë vitit 2016 dhe konkretisht 731 mijë lekë do të shlyhen nga fondi tranzitor dhe 12,373 mijë lekë nga të ardhurat e trashëguara të vitit 2015.

Tabela e investimeve nga huamarrja vendore

Emërtimi i objektit	Det 2014	PI 2015	Realizimi	Det 2015
Rikonstruksion i rrugës "Asim Vokshi" Lagjia 6		10,265,283	10,265,280	
Përmirësim i infrastrukturës rrugore në qytet (Përmirësim i ndriçimit, vendosje tabela etj)		49,970,417	47,946,215	
Mbikqyrje punimesh për ndërtimin e kompleksit multifunksional zona sportive kredia				2,024,191
Total infrastruktura rrugore (kredia)	0	60,235,700	58,211,495	2,024,191

Vlera prej 2,204 mijë lekësh do të planifikohet në buxhetin e vitit 2016.

Investime nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Gjatë vitit 2015 Bashkia ka patur investime nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve në vlerën 762,373 mijë lek dhe realizimi ka qenë në vlerën 521,733 mijë lek ose 68.4%.

Vlera e mbetur prej 240,640 mijë lek do të mbartet në vitin 2016 dhe do të përdoret me të njëjtin destinacion.

Detajimi i përdorimit të këtyre fondeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i objektit	VI e projektit	VI e kontratës	Likujdimi 2014	Likujdimi 2015	Total i likujdimit	Vlera e trashëguar 2015	% e likujdimit
1	Sheshi dhe rrugicat tek kulla Panorama sheshi tek Teatri		241,191,892	213,808,324	22,170,317	235,978,641	5,213,251	97.84%
